REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 499 Prot

Maliq, më 02.02.2026

VENDIM
Nr. 20, datë 30.01.2026
"MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËFINANCIMIT TË PROJEKTIT TË PËRBASHKËT TË BASHKISË MALIQ DHE KËSHILLIT TË QARKUT KORCË PËR MOSHËN E TRETË"

Në mbështetje të ligjit nr . 139 /2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, I ndryshuar, neni 8 neni 9 pika 1, nënpika 1.1 gërma "b", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqiperisë"*, dhe ligjit nr. 121/2016 "*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"*, dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 "P*ër shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"*, Bashkia Maliq në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Korçë do të zhvillojë një sërë aktivitetesh në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për projektin e përbashkët "Qender ditore për të moshuarit" Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq dhe Këshillit të qarkut Korcë, "Qender ditore për të moshuarit"
2. Të miratojë përdorimin e fondit lekë të deleguar nga Këshilli i Qarkut në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe projektit "Qender ditore për të moshuarit"si më poshtë :
   - Miratim fondi për "paga dhe sigurime", për një punonjës, me 8 orë pune në ditë (kujdestar salle).

Nr .	Emertimi	Vlera
1	Paga (kujdestar salle , 8 orë pune/ditë) 12 muaj	672000
2	Kontribute sigurimi shëndetësor dhe shoqëror 12 muaj	112224
	Total	784224

3. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015"*Për vetëqeverisejn vendore"* i ndryshuar.

Miratuar me 23 vota
Vota Pro 23
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.02.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ